



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 40, Datë 06.03.2020**

**MBI**

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËRKESAVE DHE PROCEDURAVE PËR  
PËRCAKTIMIN E OPERATORIT TË EMËRUAR TË TREGUT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE (NEMO) SI DHE ROLET E PËRGJEGJËSITË E NEMO DHE  
OPERATORËVE TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË NË TREGUN E  
BASHKUAR.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 57 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, VKM Nr. 322, datë 15.05.2019 “Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut”, nenit 19, pika 1, gërma f dhe nenit 26 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 06.03.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, nr. 36/2 Prot, datë 24.02.2020, mbi miratimin e Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe Rolet e Përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE me vendim Nr. 240, datë 23.12.2019, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe operatorëve të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar.
- Me shkresën nr. 32/62 Prot, datë 31.12.2019, është publikuar njoftimi në shtypin e shkruar me qëllim marrjen e opinioneve dhe komenteve nga palët e interesuara.
- Me shkresën Nr. 8 Prot. datë 06.01.2020 drafti i Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe Rolet e Përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar i është përcjellë dhe palëve të interesit për opinione.
- Në përfundim të afatit të përcaktuar për marrjen e opinioneve dhe komenteve rezultoi se nuk ka komente ose opinione nga palët e interesit për këtë rregullore.
- Bazuar në Urdhërin nr.33, datë 28.01.2020, në datën 31.01.2020, u realizua një seancë dëgjimore në ERE me pjestarët e tregut të energjisë elektrike. Në këtë seancë ishin ftuar për të marrë pjesë Përfaqësues të OST sh.a., KESH sh.a., Minsitrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe nga Autoriteti i konkurrencës.

- Përfaqsesit e KESH sh.a. dhe të OST sh.a. kërkuan në këtë seancë harmonizim të termave dhe përshtatje të tyre me aktet e tjera në fuqi. Kjo kërkesë është marrë në konsideratë pasi ndikon në përmirësimin e terminologjisë së përdorur në rregullore dhe harmonizimin e saj me akte të tjera në fuqi. Element tjetër i propozuar në senacën dëgjimore ishte mundësia e implementimit të plotë të Rregullores për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve CACA (capacity allocation and congestion management).
- Në këtë kuadër ERE vlerëson si vijon: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka propozuar që në këtë rregullore të parashikohet edhe funksionimi i Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), siç është rekomanduar nga Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB) në mbledhjen e datës 24.04.2019, i cili ka mbështetur masat rregullatore për mbështetjen e implementimit të kushteve të Bashkimit të Tregjeve të ditës në avancë në palët kontraktore të Komunitetit të Energjisë. Rregullorja për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve (capacity allocation and congestion management) (CACM) përcakton qartë se për të bërë të mundur funksionimin e Bashkimit të Tregjeve të ditës në avancë të sektorit të energjisë elektrike në vendet anëtare të Sekretariatit dhe Bashkimit Evropian, duhet të përcaktohen përgjegjësitë e operatorëve të sistemit të transmetimit (OST) dhe operatorëve të tregut të ditës në avancë (NEMO).
- Në rastin e vendit tonë duke marrë në konsideratë dhe sugjerimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe në vijim të procesit të hapur të konsultimit ku të vetmet komente janë ato të shprehura në sencën dëgjimore të datës 31.01.2020, është hartuar dhe përditësuar Rregullorja e Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe Rolet e Përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe Rolet e Përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar. (Bashkëlidhur)
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**